

Shpallje e vendit të lirë të punës

Avokat/e pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare QNL njofton të gjithë personat e interesuar se shpall pozicionin vakant për **avokat/e**.

Ky pozicion është i vlefshëm për periudhën e zbatimit nga QNL të projektit “*Për një drejtësi më të aksesueshme për burrat dhe gratë në Shqipëri*”, **1 Shtator 2017-30 Prill 2018**.

Pozicioni i punës është *full-time* dhe nuk pajtohet me ushtrimin e profesionit në pozicione të tjera.

Avokati do t’i ofrojë shërbimet ligjore falas për grupet vulnerabile, në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të kenë përfunduar studimet për Drejtësi, të barasvlershme me sistemin *Bachelor plus master*;
- Të jenë pajisur me licencën e avokatit/es;
- Të kenë eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të avokatit jo më pak se 2 vjet;
- Të zotërojnë gjuhën angleze;
- Të njohin programet bazë të kompjuterit;
- Preferohen të kenë pasur eksperiencë si anëtarë/e të skuadrave pro-bono pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare;

Me qëllim aplikimin në këtë pozicion, personat e interesuar, duhet të dërgojnë vetëm elektronikisht, në adresën e e-mailit avokatore2@yahoo.com **dokumentacionin e skanuar si vijon:**

1. CV e kandidatit/es.
2. Kopje të Diplomës, të shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve *bachelor plus master*;

3. Kopje e Licencës së avokatit/es;
4. Çdo dokumentacion të nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es;

3 Muajt e parë të punës janë periudhë e provës.

Afati i aplikimeve: 20 Gusht 2017

Seleksionimi i parë do të bëhet nga QNL mbi bazën e dokumenteve të dërguara.

Kandidatët që kalojnë fazën e parë të përzgjedhjes do të njoftohen nga QNL për datën e intervistës.

Ju mirëpresim!